FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

TETRACIKLINE
Pomadë 3%
TETRA
Pomadë për sy 1%
(Tetraciklinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Tetracikline ose Tetra dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Tetracikline ose Tetra
3. Si ta përdorni Tetracikline ose Tetra
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Tetracikline ose Tetra
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË TETRACIKLINE OSE TETRA DHE PËRSE PËRDORET
Tetracikline ose Tetra përmban si lëndë vepruese tetraciklinë klorhidrat.
Tetraciklina është një derivat gjysmësintetik i klortetraciklinës. Ajo ka veprim bakterostatik si pasojë e frenimit të rikthyeshëm të ribozomit mikrobik dhe të sintezës së proteinave. Lokalisht, tetraciklina tregohet efikase në trajtimin e infeksioneve të vogla të lëkurës të shkaktuara nga streptokokët, stafilokokët dhe baktere të tjera të ndjeshme. Tetraciklina vepron mirë mbi shkaktarin e trakomës (Chlamydia trachomatis).

Tetracikline – pomadë 3%, 15 g përdoret në:
- ulçeracione të infektuara të dermës;
- akne vulgaris;
- infeksione bakteriale në lëkurë dhe indet e buta (trajtim dhe profilaksi);
- gërvishtje, plagosje ose kafshime nga kafshët si mace, qen ose pickim nga insektet, për parandalimin e zhvillimit të infeksionit.

Tetra – pomadë për sy 1%, 5 g përdoret në:
- trajtimin e infeksioneve sipërfaqësore bakteriale të kornesë së syrit dhe konjunktivit të syrit;
- parandalimin e oftalmisë neonatorum;
- trajtimin e trakomës.

Pas një përdorimi të zgjatur të tetraciklinës, mund të keni shfaqjen e rezistencës nga mikroorganizmat.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI TETRACIKLINE OSE TETRA
Mos përdorni Tetracikline ose Tetra në qoftë se:
- jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj tetraciklinës ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të pomadës oftalmike ose pomadës dermatologjike (reaksionet e mbindjeshmërisë janë më të shpeshta në të sëmurët astmatikë);
- jeni shtatzënë ose në periudhën e ushqimit me gji.

Tetra - pomadë për sy nuk rekomandohet të kombinohet me terapi oftalmike kortikosteroidesh. Ky kombinim mund të fshehë shenjat klinike të infeksioneve bakteriale, virale ose fungale.

Tregoni kujdes të veçantë me Tetracikline ose Tetra
Pyesni mjekun tuaj përpara se të përdorni Tetracikline ose Tetra.
- Konsultohuni me mjekun tuaj për përdorimin e pomadës oftalmike dhe dermatologjike tek fëmijët.
- Pomada dermatologjike nuk duhet aplikuar në sy.
- Lejohet përdorimi i pomadës dermatologjike Tetracikline në fëmijët e moshës mbi 8 vjeç.
- Kundërindikohet përdorimi i saj për kohë të gjatë dhe në sasi të mëdha.
- Përdorimi i antibiotikut mund të shkaktojë zhvillimin e mikroorganizmave patogjene, prandaj i sëmuri duhet monitoruar me kujdes. Në qoftë se gjatë mjekimit shfaqet një infeksion i ri, duhen marrë masa të përshtatshme.
- Pomada 3% - 15 g si pomadë dermatologjike nuk mund të përdoret në mukozën e hundës, të gojës ose në sy.
- Pomada oftalmike 1% - 5 g përdoret vetëm në sy dhe jo në mukozën e gojës dhe të hundës.

Marrja e barnave të tjera:
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Tetracikline ose Tetra.
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur, keni marrë / përdorur së fundmi ose mund të merrni / përdorni barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke u trajtuar me:
- rezorcinol;
- peroksid benzoili;
- acid salicilik.

Të gjitha këto shtojnë efektet irrituese në lëkurë.

Marrja e Tetraciklinë ose Tetra me ushqim dhe pije
Duhen patur parasysh rregullat e higjienës personale dhe moskonsumimi i ushqimeve dhe i pijeve me duar të lyera me Tetracikline – pomadë dermatologjike.
Në kushtet e një higjiene personale perfekte, nuk ka ndikim marrja e ushqimit dhe konsumimi i pijeve gjatë periudhës së mjekimit me pomadë dermatologjike dhe oftalmike (aplikim lokal).

Shtatzënia
Ky bar mund të përdoret gjatë shtatzënisë vetëm në rastin kur nevoja për të e tejkalon riskun ndaj të cilit ekspozohet fetusi dhe nëna. Trajtimi me tetraciklinë i nënave shtatzëna dëmton vazhdimisht dhëmbët.

Ushqimi me gji
Kundërindikohet trajtimi me tetraciklinë gjatë ushqimit me gji të fëmijës, pasi tetraciklina edhe pse administrohet lokalisht, akumulohet në qumështin e gjirit dhe jashtëqitet me qumështin, prandaj nënat që ushqejnë fëmijën me gji nuk duhet të përdorin tetraciklinë, përveç rasteve kur nevoja për të e tejkalon riskun ndaj të cilit ekspozohet fëmija. Nga përdorimi i tetraciklinës gjatë ushqimit me gji, mund të ndodhë dekolorimi i dhëmbëve te fëmijët.
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Tetracikline – pomadë 3% nuk ka ndikim mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineritë.
Si të gjitha barnat që aplikohen në sy, edhe Tetra – pomadë për sy 1% mund të shkaktojë turbullim të përkohshëm të shikimit ose çrregullime të tjera të shikimit, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë për të drejtuar automjetin ose përdorur makineri. Nëse ndodh turbullimi i shikimit, duhet të prisni deri në qartësimin e plotë të tij përpara se të drejtoni automjetin ose përdorni makineri.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Tetracikline ose Tetra
Tetracikline – pomadë 3% përmban metilhidroksibenzoat (nipaginë) dhe propilhidroksibenzoat (nipazol), që mund të shkaktojnë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).
Tetra – pomadë për sy 1% përmban metilhidroksibenzoat (nipaginë), i cili mund të shkaktojë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).

3. SI TA PËRDORNI TETRACIKLINE OSE TETRA
Gjithmonë Tetracikline ose Tetra përdoret ekzaktësisht si ju thotë mjeku juaj. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt.

Tetracikline – pomadë 3%, 15 g
Pas pastrimit të lëkurës, aplikohet lokalisht në shtresë të hollë 2 herë në ditë. Pomada përhapet lehtësisht me mollëzën e gishtit deri sa të mos duket. Në infeksionet bakteriale të lëkurës nevojitet mjekim deri në 1 javë ndërsa në akne deri 3 javë (në format e lehta dhe mesatare mjafton mjekimi lokal ndërsa në format e rënda, mjekimi lokal mund të kombinohet me marrjen e tabletave nga goja, 1.5 g / ditë e ndarë në 3 pjesë që merren 1 orë para ose 2 orë pas ushqimit).

Tetra – pomadë për sy 1%, 5 g
Për trajtimin e infeksioneve bakteriale dhe trakomës:
Pomada për sy (1%) aplikohet rreth 1 cm në konjunktivë, çdo 2-4 orë.

Për trajtimin e oftalmisë neonatorum:
Aplikohet një dozë e vetme pomadë (1 cm).

Fillimi i mjekimit dhe ripërsëritja e tij duhet të bëhet vetëm pas një ekzaminimi të kujdesshëm të të sëmurit nga mjeku specialist nëpërmjet kontrollit me biomikroskop etj. Nëse mjekimi zgjat mbi 10 ditë duhet kontrolluar presioni intraokular.

Për administrimin e Tetra - pomadë për sy 1% ndiqni udhëzimet e mëposhtme:
- Lajini mirë duart.
- Maja e tubetit të mos bjerë në kontakt me qerpikët, konjunktivën, lëkurën, gishtërinjtë ose sipërfaqe të tjera.
- Mos e prekni vendin e daljes së pomadës.
- Shikoni lart.
- Ulni kapakun e poshtëm të syrit për të krijuar një ulluk.
- Vendosni majën e tubetit sa më afër ullukut, por pa e prekur atë.
- Hidhni sasinë e duhur në ulluk.
- Mbyllni syrin për rreth 2 minuta.
- Përdorimi i të njëjtit tubet në më shumë se një të sëmurë mund të bëhet shkak për të shpërndarë infeksionin.

Preparati duhet të mbahet i mbyllur në kohën kur nuk përdoret, sepse kur nuk tregohet kujdesi i duhur, mund të kontaminohet dhe të shkaktojë infeksione të syrit të cilat bëhen shkak për dëmtime serioze të syrit dhe të shikimit.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Tetracikline ose Tetra
Tetraciklina përthithet mirë nga lëkura kur përdoret lokalisht prandaj duhet të tregohet kujdes që të mos përdoret me sasi të mëdha sepse mund të shkaktojë irritime të lëkurës edhe djegie të saj.
Në qoftë se keni përdorur më shumë Tetracikline ose Tetra se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të përdorni Tetracikline ose Tetra
Në qoftë se harroni aplikimin e një doze (ose më shumë dozave), aplikoni dozën në vazhdim kur të jetë koha për aplikimin e zakonshëm të saj.
Mos aplikoni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtyre produkteve, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjithë barnat e tjerë, Tetracikline ose Tetra mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.

Disa efekte anësore të mundshme të Tetracikline – pomadë 3% janë:
- ngjyrosje e lëkurës në vendin e përdorimit, por njolla pastrohet me larje;
- fluoreshencë e vendeve të trajtuara nga rrezet ultraviolet;
- irritim, kruarje, skuqje, djegie ose edema në vendin e aplikimit;
- shumë rrallë dermatit;
- në të sëmurët me insufiçiencë renale, nëse mjekimi lokal plotësohet me dhënien e dozës së plotë nga goja, mund të shkaktohen dëmtime të mëlçisë.

Tetra – pomadë për sy 1%, 5 g:
- irritim, kruarje dhe djegie të kapakëve të syve;
- mund të shkaktojë çrregullime të shikimit.

5. SI TA RUANI TETRACIKLINE OSE TETRA
Mos e përdorni barin pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.
Të ruhet në një vend të freskët, nën 25°C!
Të mbahet larg fëmijëve.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Tetracikline – pomadë 3%, 15 g
Lënda vepruese është tetraciklinë klorhidrat.
1 g pomadë përmban 30 mg tetraciklinë klorhidrat.
Përbërës të tjerë: vazelinë, vaj vazeline, dioksid silici koloidal, metilhidroksibenzoat (nipaginë) dhe propilhidroksibenzoat (nipazol).

Çfarë përmban Tetra – pomadë për sy 1%, 5 g
Lënda vepruese është tetraciklinë klorhidrat.
1 g pomadë për sy përmban 10 mg tetraciklinë klorhidrat.
Përbërës të tjerë: vazelinë, vaj vazeline dhe metilhidroksibenzoat (nipaginë).

Përmbajtja e paketimit
Tetracikline – pomadë 3%: kuti me 1 tubet 15 g.
Tetra – pomadë për sy 1%: kuti me 1 tubet steril 5 g.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:
Sipas recetës së mjekut.
Përmbajtja. Kujdes.
Pomadë / Pomadë për sy.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Prill 2016.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.